



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

## Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 10.12.2020

- I. Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 04.12.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "**INTERNATIONAL SECURITY ASSOCIATION**" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Gjakovës**", me Nr. të Prok: 632-20-7505-2-1-1, Nr. Brendshëm 632-20-119-211. nxjerr:

### V E N D I M

- II. 1. **Refuzohet si** e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "**INTERNATIONAL SECURITY ASSOCIATION**" SH.P.K., e dt. 04.12.2020, lidhur me aktivitetin e prokurimit "**Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Gjakovës**", me Nr. të Prok: 632-20-7505-2-1-1, Nr. Brendshëm 632-20-119-211., kundër **Dosjes së tenderit**, te AK –së, të datës 30.11.2020, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së .
2. Vërtetohet **DOSJA E TENDERIT E AUTORITETIT KONTRAKTUES** të publikuar me datë: 30.11.2020;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

## Arsyetim

- I. Operatori Ekonomik "INTERNATIONAL SECURITY ASSOCIATION" SH.P.K.me datë 04.12.2020, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Gjakovës", me Nr. të Prok: 632-20-7505-2-1-1, Nr. Brendshëm 632-20-119-211.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 10.12.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Kërkesa e juaj për anulimin e tenderit është e pa bazë, sepse në kërkesën tuaj dhe në kalkulimet tuaja të prezantuara në kërkesën për anulim, sasinë e orëve të kërkuara në dosjen e tenderit për "Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Gjakovës", e keni konsideruar si fikse dhe të mirëqenë, ajo është sasia e parashikuar është vetëm sasi Indikative. Devijimi i lejuar nga sasia totale indikative është 30% +/-.

*Andaj ky fakt mjafton që kërkesa e juaj të konsiderohet e pa bazë.*

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

### Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit



Kopje: Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit të Komunës;  
Te gjitha palëve të interesuara;  
Arkivit të Komunës